



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKË KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA	
Prenimi - Përmijeno identiteti	13.02.2020 vjqp
Nr. I organizatës / Nume/Emri / Nr. e brojtimit	Vlera Mëdha
01-370/dh-6920	



Komuna e Vitise
Opština Vitina
Municipality of Vitina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 / 15, Qershori 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitise, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ne Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitise, Nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitise bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **II** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **20.02.2020 (e enjte)**, duke filluar në ora 10,00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave tek objektin i ri i Komunës së Vitise.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitise, si monument i natyrës.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitise si monument i natyrës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungjet e Qarrit (*quercus cerris*) në Binçë të Vitise, si monument i natyrës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Qarrit (*quercus cerris*) në Gërmovë të Vitise si monument i natyrës.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Pylli i Mllakes (*quercus sp.*) në Sllatinë të Epërme të Vitise, si monument i natyrës.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (*quercus sp.*) në Sllatinë të Poshtme të Vitise, si monument i natyrës.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Guri i Blinave në Gjylekar të Vitise si monument i natyrës.
9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për komunitete për vitin 2020.
10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2020, dhe raporti i punës së këtij komitetit për vitin 2019.
11. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport për vitin 2020.
12. Informatë nga zyra e prokurimit mbi raportin e prokurimit dhe planifikimi final i prokurimit për vitin 2019.
13. Raport pune nga Zyra e Personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Me respekt!

Viti, më 13.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Pira



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **23.01.2020 (e Enjte)**, në Zyrën e konferencave në objektin e ri të Komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtiveve, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent OSBE-në ju bashkim që merrni pjesë në këtë mbledhje media të shkruara dhe elektronike si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Uroj që të kemi një vit të mbarë.

Nëse ka dikush tjetër ndonjë pyetje, atëherë për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2019
3. Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2020 dhe plani strategjik për njësinë e Auditimi të brendshëm në Komunën e Vitisë 2020-2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete.

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm? Fjala është për ju.

z.Bekim Azizi: Ka një kohë që e kam kërkuar për ndërtimet pa leje, jeni zotuar që keni me sjellë ka 6 muaj që nuk keni bërë asgjë rreth kësaj kërkese.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kërkosat që ju i bëni janë edhe anëtaret e ekzekutivit këtu drejtoret tashtë moment se bëhet kërkesa ata janë të obliguar me ja u sjellë. Moment se mi sjellin mua si kërkesa, unë dërgoj në kuvend. Le të mbetet që kjo është kërkësë e anëtarit të KPF-së, që një pikë e tillë të sjellët në mbledhjen tjetër. Lus sekretarin me shkrim me ja dërgua Drejtorisë së Inspeksionit, që seancën e radhës të na i sjellë si informatë në KPF. Nëse nuk ka dikush tjetër, unë e kam edhe një propozim, meqenës orarin e mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së dhe të kuvendit kam harruar me sjellë me futë edhe këtë

pike tē rendit tē ditës, atëherë kush është që tē miratohet ky rend dite me këtë pikën shtesë ju lutëm? Konstatoi se me vota unanime kalon rendi i ditës.

Si pikë tē parë kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Para se me ja u kalu fjalën, unë kam një vërejtje te lektori, që po më duket që nuk e ka lektoruar, sepse ky procesverbal ka gabime gjuhësore dhe këto mbesin si dokumente. P.sh.: sugjeroftshin, intituti i përfaqësuar, s'po kuptoj çka ka lektoruar këtu në faqen e parë. Unë kam mund më thanë kam sugjeruar po sugjeroftshin s'po besoj që e kam përdorur.

zpj.Gjylsime Qamili: Edhe unë do tē ndalem te faqe 4. Mua më ka pyetur Jakupi, ka thanë a vaksinohen fëmijët me pagesë a pa pagesë. Unë kam thanë fëmijët vaksinohen pa pagesë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Me vërejtjet që u dhanë dhe kërkoj që tē përmirësohen nga sekretaria, unë e hedhi në votim pikën e parë. Konstatoj se me vota unanime kalon pika e parë.

Si pikë tē dytë tē rendit tē ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2019

Ja kisha Kaluar fjalën drejtorit rrith kësaj pike tē rendit tē ditës.

z.Ibrahim Rama: Kjo është në procedurë ligjore, që Drejtoria e Financave jeni tē detyruar që për çdo tre muaj tē paraqesim pasqyrat financiare të cilat pasqyrojnë shpenzimet e buxhetit. Kësaj radhe pasqyrat financiare janar - dhjetor për vitin 2019, për komplet vitin fiskal dhe pjesa tjetër që ka tē bëjë me mbushjen e buxhetit nga tē hyrat tē nivelit qendror nga grandet specifike dhe tē hyrat vetanake, që me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale, komuna është e obliguar tē mbledh. Për mos me ju marr shumë kohë pasi materialin e keni marr me kohë, unë në pika tē shkurtra në faqe 2, ku shihet komplet buxheti i Komunës së Vitisë, i cili ka qenë i alokuar për vitin 2019, 11 milion 391 mijë euro. Janë shpenzuar 11 milion 327 mijë, apo ma mirë me thanë 99,94% sipas sektorëve tē kategorisë së shpenzimeve, paga dhe mëditje 99,98 %, mallra dhe shërbime 98,6 %, shpenzime komunale 99,83%, subvencione 94,30% dhe shpenzime kapitale 98,87 % si dhe në faqe 19, kemi tē hyrat tē planifikuara. Ka pas 1 milion e 42 mijë 978 euro, kurse janë grumbulluar 1 milion e 100 mijë 40 mijë 521 euro. Në përqindje 109,35%. Kjo ishte në pika tē shkurtra. Pasi materialin e keni marrë me kohë, për pyetje përgjigjje jam në dispozicion tē ju ndihmoj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rrith kësaj pike tē rendit tē ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Bekim Azizi: Unë kisha kérkuar që për kuvend kartela analitike e shpenzimeve financiare, si dokument me ma sjell atë pjesën, e desha me bërë krahasimin. Tjetra, çka po lidhem këtu tash një vit kur po sjellën raportet, kanë qenë mbi 100 mijë, tash këtu po na del 378 mijë 921 euro, janë paguar tē viti paraprak obligime, pse nuk po na vjen informata e njëjtë sa ki obligime këtu. Ajo çka po thua ti nuk po përputhet që unë prapë mundem me dyshua, se prapë nuk i ke paguar tē gjitha borxhet e viti paraprak. Kjo tregon se nuk po na sjellën informatat e plota. Tjetra, te drekat zyrtare. Këtë vit është enorme, 30 mijë euro i keni shpenzime. Ju e dini kur e keni nis vitin e parë 13 mijë euro i keni pas hargjuar, bile ju kam pas thanë hani pak ma shumë se s'jeni tu punuar, ndërsa tash e keni kaluar 30 mijë euro. Në kuadër tē saj i ke paraqitur se te flakadani janë 8 mijë euro dhe një 2/3 mijë euro te drekat mësimdhënësve, tjerat janë dreka zyrtare. Kodi 14 310, këtë tē flakadanit edhe dreka tē mësuesit nul ke nevojë me i sjellë a tē tjerat a ka mundësi me i specifikuar se kam dëshmi se edhe drejtoret kur han darka në Viti i thuani shkruama një faturë tē komunës. Është hera parë që po ju a kërkoj, se keni filluar me hangëri si shumë edhe kanë filluar me ju bë edhe zarar, se edhe prokuroret kanë filluar me dis hetime që nuk i keni punët bash mirë, keni kujdese këto ditë. Edhe informatë tjetër, edhe këto kontratë në vepër, se na e dimë që vitin e kaluar një punëtor i juaji me kontrata mbi vepër i ka marr 13 paga r bazë tē shënimëve që na i ke sjell tū ke deklaruat ti, konkretisht se do tē merrem me këtë punë edhe nti ke bë asgjë

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë nëse ka mundësi përmes e-mailles me ta dërguar dhe t'i i nxjerrë ato të cilat të duhen. Si do që të ietë mundësia, është kërkesë e anëtarit të KPF-së. Dikush tietër.

z.Jakup Demiri: Këtë listën shtesë, mirë që e paske pas sjellë drejtor, por me pas mundësi me pas sjell me kohë ka qenë ma mirë. Kërkesën e kam te vendimet e gjykatës, janë 90 mijë euro, a mundeni me i sjellë në kuvend, për çka bëhet fjalë me një sjell si informatë në kuvend. Te shërbimet e ndryshme shëndetësore, është 122 mijë euro, kodi është 13 430. A mundemi mi pas të detajuara për kuvend. Te borxhi i rrymës, a hinë edhe pagesat e që janë te kodi 13210. Edhe tek obligimet që kanë mbet prej viti paraprak, qysh po realizohen.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Do te mundohem ta sjelli kërkesën e Bekimit, shpenzimet analitike që i kërkoj Bekimi pagesa e obligimeve me 31.12.2019. Unë e kam përgatit 90% listën e obligimeve që i trashëgomi për 2020, s'un e përfundova krejt që me ju sjell për kuvend. Keni me pas listën e saktë sa obligime të trashëguara i ka komuna prej 2019, me investime kapitale, me shërbime, mallra, me subvencione të vitit 2020, edhe sa pare na barten që nuk i kemi hargju këtë vit. Sa ka pare tepër sa ka obligime komuna, keni me pa saktë në kuvend. Një pyetje ishte tek kodi 14310 shpenzimet që kanë të bëjnë me dreka zyrtare edhe këtë specifikacion ka me përgatit dhe me kontrata e me shërbime të veçanta ja kam dhanë. Po ju sjelli prapë, masi që po e kërkoni, edhe për gjykata edhe këtë e sjelli e kërkoj Jakupi. Shërbime, kodi 13430 shpenzime shëndetësore, shuma 120 mijë euro. Këto cekën në pasqyra, janë të gjitha që i kemi pagu Karitas Kosovës në seli ne Ferizaj, për shërbime shëndetësore që i kanë Komuna e Vitisë.

z.Bekim Azizi: Te mëditjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit. Po më intereson qëky Mervan Mustafa, Milot Haziri, ka 846 euro dhe Defrim Pira. Çka kanë bë këta, çfarë udhëtime zyrtare kanë pas, çka kanë përfituit, çka kanë pas interes komuna që janë shku këta. Për Defrimin po e di, që e kanë marr si përkthyes, po këta dy tjerët çka kanë kërku atje.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Disa aktivitete janë prit mu realizu, besoj që takimi aty për aty nuk e merr produktin, besoj që do të shofim përfitimet, ka qenë një udhëtim zyrtar. Këta kanë qenë pjesë të delegacionit. Unë nuk kam informacione ma shumë.

z.Bekim Azizi: Ndoshta nënkyetari e dinë me shumë çka ka përfitua komuna, çka ka pas nevojë me shku Mervani e Miloti atje.

Nënkyetari z.Hasan Aliu: E kanë shoqëru ekipin këta, dy biletat i kanë pagu vet, ndërsa komuna e ka pagu vetëm mëditjet e tyre, a ka qenë të nevojshëm me shku apo mos me shku është një çështje tjetër, po ka qenë si ekip, unë as nuk i kam njoftë këta djem, cilat do të jan rezultatet, ka premtime që do të ketë edhe në aspekt të shkollimit të pajisjeve të shkollave me teknologji informative të ndryshme, megjithatë janë ato që priten.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ftesa ka ardh në emër të kryetarit, po pjesë e delegacionit në ftesë janë kanë edhe këta persona që janë kanë pjesë të aktiviteteve që ka fillu me herët.

z.Bekim Azizi: Po me intereson me ditë, çka, kanë e kanë përfaqësu këta dy që janë shku.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Këta kanë shku me e gjet mundësinë e donacioneve të ndryshme, që qaj qytet i Amerikës me i ndimu Komunës së Vitisë.

z.Bekim Azizi: Drejtor, qeto informata që i ki ti, konsultohu edhe me këta që janë shku edhe me mi sjellë me shkrim në kuvend. Çka, kanë pas takime, çka kanë përfaqësu atje, çka kanë me marrëveshje, çka kanë ngrit atje që kemi interes ne si komune, pasi që u pagu prej parave të qytetarëve një informatë Kërkoj për këta tre që kanë qenë atje.

z.Jakup Demiri: Te shërbimet e ndryshme shëndetësore, përkujdesje shtëpiake, Karitas, një informatë edhe për këtë me sjellë.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Informatat janë në Karitas Kosova, me procedurat e rekrutimit, me krejt Ne i kemi faturat që i kemi bë pagesat, ndërsa procedurat tjera janë në administratën e Karitas Kosovës. Unë muj me ti sjellë faturat.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po ju falënderoj për kontributin që dhatë në këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën tjetër.

Si pike tē tretë tē rendit tē ditës kemi:

3. Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2020 dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Vitisë 2020-2022

z.Fevzi Mehmeti, shef i Zyrës së Auditimit: Përshëndetje tē nderuar tē pranishëm! Njësia e Auditimit të Brendshëm, duke u bazuar në Ligjin e Kontrollit Financiar, Ligji Nr. L-023, Zyra e Auditimit të Brendshëm është e obliguar që çdo vit tē harton planin strategjik trevjeçar dhe planin vjetor për vitin kalendarik. Ne para se me e miratu. Para se me e hartu një plan strategjik, ju dërgoj secilës drejtori ka një shkresë që tē kemi një bashkëpunim, se cilat fusha ata drejtor janë tē interesuar me e auditu. Drejtorat nuk na kanë kthye përgjigje, ne kemi qenë tē obliguar tē hartojmë planin vjetor 2020 dhe planin strategjik 2020-2022, tē cilin plan jemi tē obliguar tē përcjellim te Kryetari i Komunës dhe Komitetit i Auditimit të Brendshëm për miratim, tē cilën edhe e kemi bë. Pas miratimi një kopje i dorëzohet Ministrisë së Financave deri ne përfundim tē vitit, d.m.th deri me 31.12.2019, që ne e kemi bë këtë gjë, e kemi përcjell në afatet ligjore. Te plani strategjik është përfshi e gjithë veprimtaria e fushave tē cilat Njësia e Auditimit të Brendshëm e kryen auditimin brenda një viti. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesiesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pike.

z.Bekim Azizi: Asnjëherë nuk e kemi pas një raport tē punës ose tē gjeturave që i ki gjet ti. Vitin e kaluar kam kërkua me na sjell raport tē auditimit të brendshëm, po nuk e keni sjell në kuvend. Nuk e di unë çfarë kuptimi ka që naj sjell sot këtë dhe naj prezanton e në fund tē vitit na nuk e dimi një raport tanin për punën tane që e ki bë me bashkëpunëtorët tu dhe nuk e dimi një gjendje tē fund tē vitit për punën që e ke kry dhe gjetje që i ki bë. Kjo është përmu jo në rregull. Ne duhet me pa edhe një raport tanin, një bilanc për punën tënde, për tē gjeturat e tua, sa e ke përmbush këtë plan tē punës që e ke parapë ti, cilat janë vlerësimet e tua, sugjerimet e tua për komunën për zbatimin e këtij plani.

z.Fevzi Mehmeti, shef i Zyrës së Auditimit: Ky është plan publik, i cili është përmenaxhmentin. Mund tē publikohen në web faqe tē komunës, që ta shohin edhe drejtorët, se në cilën kohë e kemi planifikuar ta bëjmë auditimin, ndërsa sa i përket raportit tē Njësisë së Auditimit të Brendshëm, bazë Ligjet tē Auditimit të Brendshëm, drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, është i obliguar t'i raportoj kryetarit tē komunës, KPF-së, Komitetit për Auditim tē Brendshëm dhe Ministrisë së Financave. Këto janë fushat që duhet me i raportu ne. Sa i përket anës time, asgjë nuk paraqet problem po mbi bazën e ligjit, këto që i ceka janë ato që me obligojnë mu me i raportu.

z.Bekim Azizi: Auditori i jashtëm nuk i jep raport kuvendit, mirëpo neve na vjen një informatë e auditorit tē jashtëm, e cila informatë na vjen në kuvend, e neve nuk na vjen një informatë e auditorit tē brendshëm, që është pjesë e jona. Kjo është jo në rregull, ne duhet me pas një informatë për punën tënde që e ki pas gjatë vitit.

z.Fevzi Mehmeti, shef i Zyrës së Auditimit: Zyra Kombëtare e Auditimit e ka një fushë se e caktion për punën e Komitetit tē Auditimit dhe Njësisë së Auditimit, prandaj ne raportin e Zyrës Kombëtare është vlerësimi i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, është një pik aty.

Nënkyetari z.Hasan Aliu: Aspekti ligjor e obligon ekzekutivin që një informatë tē auditorit tē jashtëm me e qu në kuvend, ndërsa nuk e obligon për auditimin e brendshëm, tu e pas parasysh se kryetari i komunës dy herë në vit e informon kuvendin dhe në atë informatë është e paraqitur edhe puna e auditorit tē brendshëm. Megjithatë, nëse këshilltarët e kuvendit komunal e kërkojnë, nuk është e ndalushme me e sjell në kuvend.

z.Bekim Azizi: Unë në dy seanca e kam kërkuar vitin e kaluar, unë mendoj që duhet me ardh një informatë përmes raportin e brendshëm tē auditori me kërkësën tonë, mendoj që duhet me ardh.

Kryesues z.Naim Pira: Pasi që nuk ka tē tjerë për diskutim, kalojmë në piken tjetër tē rendit tē ditës

Si pikë tē katër:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunë e Vitisë

z.Mustaf Mehmeti, zyrtar nga Zyra e Informimit: Përshëndetje tē nderuar tē pranishëm! Zyra pë Informim Publik kemi përgatit këtë draft rregullore, e cila ka qen në shqyrtim publik një muaj. Nu

kemi pas pjesëmarrje të madhe në diskutimi publik, të cilin e kemi mbajt. Sa i përket komenteve, kemi pas komente nga organizatat joqeveritare Eolog dhe nga Komiteti për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimarrje. Fatkeqësish ato komente nuk kemi muj me i perisni, sepse kane qenë në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me pakon ligjore për transparencën. Rregullore e keni pranuar me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicioni e juaj.

Kryesues z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim për miratim. Konstatoj që shkon për kuvend.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa

Ju e dini që kur e kemi themelu KPF-në, jeni dakordu që në KPF dy vite të janë dy përfaqësues nga LVV dhe pas dy vite të jete nga PDK-ja, për shkak numrit që kanë pas në kuvend këto dy subjekte politike. E hapi debatin për këtë pikë. Nëse nuk ka, po e qes në votim për miratim. Edhe kjo pikë votohet dhe shkon për në kuvend.

Si pik të gjatë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete

Edhe te kjo pikë janë dakordu dy partitë politike, këtu e kemi edhe emrat, ku z.Rasim Terziqin e zëvendëson, z.Besim Ymeri. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Edhe kjo pikë e rendit të ditës votohet dhe shkon për në kuvend.

Si pik të shtat të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Hapi debat edhe për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim edhe këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundon në ora: 11:10

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
z. Naim Pira



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-02-2020

02-035/02-136



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, neni 17, pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50, shkronja 1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës së Vitisë propozon që të merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Trungu i Bungbutës** (*Quercus pubescens*) në fshatin Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen **prej 5 ari**.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm pér territorin e Komunës së Vitisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 15 m, perimetri i kërcellit është rreth 6m, diametri i kurorës rreth 15 m dhe vjetërsia është mbi 150 vite.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur *Luka*, në afërsi të varrezave të fshatit, në parcelën 1624-0, zona kadastrale Zhiti, nr. P-70101023-01624-0, me sipërfaqe 3030 m², e regjistruar si varreza, në pronësi private në emër të Zeqir (Sylë) Okushini.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- a) Prerja e trungut dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- b) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- c) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- d) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- e) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës, nën kushtet të cilat i përcakton Institut i Kosovës pér Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit pér sanimin e gjendjes

së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes drejtorisë përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK-së dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-02-2020

02-035/02-135



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, neni 17 pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës Nr. 85/2010), neni 50 Nr. 03/L-233 përmes të cilave është marrë mësimi që burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon që merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Burimi i ujit termomineral** në fshatin Ballancë të Vitisë si monument i natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej **3.18 ari apo në zonën e rreptë mbrojtëse në rrëze 10m.**
Monumenti i Natyrës me vlerat e tij natyrore është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Uji i thartë, rrëth 500 m në dalje të fshatit (rruga përmes Kishnapole), në parcelën 1152-0, zona kadastrale Ballancë, nr. P-70101001-01152-0, me sipërfaqe 8989 m², në pronësi private në emër të Sherif (Iliaz) Zeqiri.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- a) Ndërhyrja në burim dhe rrëth tij;
- b) Çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme të burimit;
- c) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- d) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- e) Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- f) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës përmes të cilave është marrë mësimi që burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Neni 5

Për zbatimin e mašave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes drejtorisë përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK-së dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vëtitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11.02.2020

02 - 035/02-134



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, nenit 17, pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungjet e Qarrit (*Quercus cerris*) në Binçë të Vitisë, si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës së Vitisë propozon që merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Trungjet e Qarrit** (*Quercus cerris*) në fshatin Binçë të Vitisë, si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërsfaqen prej **13.97 ari**.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vitisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 30-35 m, perimetri i kërcellit të trungjeve është prej 1.60 - 3.60m, diametri i kurorës prej 20-30 m dhe vjetërsia është mbi 150 vite.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Oborishtë në lagjen e Shoshve, përbollë varrezave katolike të fshatit, në parcelën 1428-1, zona kadastrale Binçë, nr. P-70101003-01438-0, me sipërsfaqe 539 m², në pronësi private në emër të Viktor (Dodë) Zefiq.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN - është kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- Prerja e trungjeve dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërsfaqen e mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërsfaqen së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërsfaqen e mbrojtur; dhe
- Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes Drejtorese përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrotjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrotura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrotjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-02-2020

02-035/02-133



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, neni 17 pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Qarrit (*quercus cerris*) në Gërmovë të Vitisë si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës së Vitisë propozon që të merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Trungu i Qarrit** (*Quercus cerris*) në fshatin Gërmovë të Vitisë, si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej **5 ari**.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vitisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 20 m, perimetri i kërcellit është rreth 3 m, diametri i kurorës rreth 20 m dhe vjetërsia është mbi 150 vite.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Vakufski Zabran Ekono. Dvo., në parcelën 749-1, zona kadastrale Germovë, nr. P-70101014-00749-1, me sipërfaqe 39460 m², e regjistruar si varreza, në pronësi shoqërore të Kombinatit Bujqësor Morava.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- Prerja e trungut dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Institut i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes Drejtorisë përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vëtitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11.02.2020

02-035/02-131



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, nen 17 pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Pylli i Mllakes (*quercus sp.*) në Sllatinë të Epërme të Vitisë, si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës së Vitisë propozon që të merret nën mbrojtje vlera e natyrës Pylli i Mllakes (*Quercus sp.*) në fshatin Sllatinë të Epërme të Vitisë, si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej **13.70 ha**.

Monumenti i Natyrës ka vlera të veçanta botanike dhe peizazhere, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore që si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Koj Breg ose Mllak, në parcelën 1187-0, zona kadastrale Sllatinë e Epërme, nr. P-70101037-01187-0, me sipërfaqe 81934 m^2 , në pronësi shoqërore të Koperativës së Përgjithshme Bujqësore Vitia.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- Prerja e trungeve dhe çfarëdo veprimitarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes Drejtorise përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK-së dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vëtitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-03-2020
02-035/02-132



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, neni 17, pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (*quercus sp.*) në Sllatinë të Poshtme të Vitisë, si monument i natyrës

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kryetari i Komunës së Vitisë propozon që të merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Kompleksi i Trungjeve të Dushkut** (*Quercus sp.*) në fshatin Sllatinë e Poshtme të Vitisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej **2.00 ha**.

Monumenti i Natyrës ka vlera të veçanta botanike, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore që si i tille është i rrallë jo vetëm pér territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Jezero, në varreza të fshatit, në parcelën 1801-0, zona kadastrale Sllatinë, nr. P-70101037-01801-0, me sipërfaqe 17332 m^2 , në pronësi shoqërore të K.K. Viti.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- Prerja e trungjeve dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës pér Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit pér sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes Drejtorise përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK-së dhe është i detyruar që:

- Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

11-02-2020

02-035/02-130



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h, nen 17 pikë e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës Nr. 85/2010), nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Guri i Blinave në Gjylekar të Vitisë si monument i natyrës

Me këtë propozim vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë propozon që të merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Guri i Blinave** në fshatin Gjylekar të Vitisë si monument i natyrës i karakterit gjemorfolologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës përfshinë sipërfaqen prej **20 ari**.

Monumenti i Natyrës me vlerat e tij natyrore është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në periferi të fshatit në pjesën lindore, në parcelën 1571-1, zona kadastrale Gjylekar, nr. P-70101022-01571-1, me sipërfaqe 380811 m^2 , e regjistruar si kulloso në pronësi të Kooperativës Bujqësore.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- Ndërhyrja në burim dhe rrëth tij;
- Çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme të burimit;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur; dhe
- Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vitisë përmes drejtorisë përkatëse – DUPMM-së, DSHPE-së dhe DGJK-së dhe është i detyruar që:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës munden ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vëtitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 6

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.


Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 51, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d), lidhur me nenin 44 , të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR APPROVIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

Neni 1

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Planin e punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2020, për Komunën e Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi dhe Planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, për Komunën e Vitisë do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Ky propozim vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

PROPOZUES: KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira



PROPOZIM

I Planit të Punës të Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë

Periudha: Janar-Dhjetor 2020

